


# DEMOKRACIA PËRRETH BOTËS



## GAZETARËT E KUVENDIT

MRIKA (9), OLTİ (9), KANİTA (9), HAKİF (9), RİNESHA (9), ELSA (9), ERJONA (9), BELİNA (9), PONTI (9)



### Si çdo shtet demokratik që ka Kuvendin e tij, edhe Kosova ka Kuvendin e vet

Kosova është shtet demokratik dhe ka Kuvendin e vet. Kuvendi është institucion i shtetit. Kuvendi ndryshe quhet „Shtëpia e Popullit“ sepse e përfaqëson atë. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kuvendit janë: të miratoj ligje, të miratoj buxhetin e shtetit, të zgjedh Presidentin e vendit, të kontrolloj dhe të mbikëqyr Qeverinë, etj. Kuvendi ndryshe quhet edhe Pushtet Legjislativ sepse miraton ligje. Në Kuvend bëjnë pjesë: Kryetari i Kuvendit, nënkryetarët, deputetët, etj.

Ne kemi mësuar se Kuvendi është përfaqësues i popullit. Kuvendi e përfaqëson popullin me anë të deputetëve. Këta deputetë zgjedhen nga populli me anë të votave në procese zgjedhore.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka 120 përfaqësues të popullit (deputetë). 100 prej këtyre deputetëve janë

të komunitetit shqiptar, kurse 20 prej tyre janë të komuniteteve jo shumicë.

Ne nuk kemi të drejtë të votojmë për zgjedhje qendrore ose komunale pa i mbushur 18 vjet. Kur të arrijmë këtë moshë, ne do të kemi mundësi t'i votojmë ata, të cilët dëshirojmë të na përfaqësojnë. Po ashtu, në këtë moshë ne mund të kandidojmë edhe për deputetë.



Flamuri i Republikës së Kosovës



Gazetarët gjatë punës së tyre



Grupi i gazetarëve të rinjë

# E DREJTA PËR VOTIM

ERIS (9), MERISA (9), EDI (9), DION (10), JARITA (8), THURAJA (9), LEA (9), DARIS (9), SUMEA (9),  
LARTIN (9)

**Ne jemi klasa IV-2 nga shkolla „MODEL“ dhe sot në Punëtoritë e Demokracisë kemi mësuar për votimin dhe zgjedhjet**

Ne sot kemi biseduar për votimin dhe zgjedhjet. Gjithashtu, ne gjatë Punëtorisë kemi votuar për të zgjedhur lojën që kemi dëshiruar. Për herë të parë zgjedhjet filluan në shekullin e 17-të. Edhe pse në fillimet e demokracisë vetëm meshkujt të cilët kanë qenë të pasur kanë mundur të votojnë, në shekullin e 17-të kanë votuar të gjithë meshkujt. Pas kësaj periudhe, kanë votuar në mënyrë të barabartë femrat dhe meshkujt. Sot kemi qenë kandidatë për deputetë dhe President dhe kemi shkruar programin tonë se si dëshirojmë të jetë Kosova, kur ne të rritemi. Në ditët e sotme njerëzit mund të votojnë mbi moshën 18 vjeçare. Tani ne i kemi të drejtat e barabarta për votim dhe ne jemi shumë të gëzuar për këtë gjë.




Votuesit e së ardhmes

Të drejtat tona të ilustruara në duar




Kandidimi për President dhe për deputetë



Të gjithë kemi të drejta të barabarta për votim



Ne jemi duke e shkruar artikullin



## INSTITUCIONET DEMOKRATIKE

DEA (9), DION (9), DIELL (8), ETNIK (9), EDONIS (9), ELMA (10), JORA (9), LORETA (9), MUHAMET (9)

**Institucionet demokratike të Kosovës janë të ndara nga njëra-tjetra dhe kanë funksione të ndryshme. Këto institucione janë: Gjykata, Qeveria dhe Kuvendi**


Demokracia është sistem që secilit njeri i mundëson që të jetoj i lirë dhe i barabartë me të tjerët. Edhe ne si fëmijë kemi shumë të drejta, por kemi edhe shumë përgjegjësi, e të gjitha këto na mundëson vendi ynë. Vendi ynë që të funksionojë në mënyrë demokratike, e ka bërë ndarjen e pushtetit në mes të institucioneve. P.sh. Kuvendi ka detyra të ndryshme nga Qeveria dhe gjykata. Qeveria propozon projektligjet që pastaj shkojnë në Kuvend dhe pastaj Kuvendi vendos që t'i miratoj apo jo. Nëse ligji miratohet, pastaj Qeveria është ajo që e zbaton. Po ashtu, edhe gjykata është e pavarur në punën e saj.

Kjo ndarje e pushtetit është bërë që secila prej këtyre që i thamë më lart të kryej detyrën e vet në mënyrë të pavarur.



Puna në grup

Këtë kemi paraqitur Gjykatën Supreme



Vizatimin e punuam unë Dea dhe Edonisi.

Në vizatimin e dytë kemi paraqitur në tërësi ndarjen e pushtetit



Vizatimin e punuam unë Dielli dhe Loreta

Në pemë është paraqitur se si funksionon Pushteti Legjislativ- Kuvendi



Punimi është bërë nga Jora dhe Muhameti.



Tekstin e shkruan: Etniku, Dioni dhe Elma

## QYTETARËT NË DEMOKRACI

FJOLLA (10), ENSAR (9), ELIONA (9), RONA (9), ATDHE (9), ARTA (9), VALDRIN (9), VALA (9), REINA (9)



Ne në këtë foto kemi paraqitur disa nga të drejtat tona

### TË DREJTAT TONA NË DEMOKRACI

Demokracia është udhëheqje nga populli. Kemi dy lloje: demokracinë e drejtpërdrejtë dhe atë përfaqësuese. Në demokracinë e drejtpërdrejtë, i gjithë populli vendos se si do të funksionojë vendi, kurse në demokracinë përfaqësuese populli zgjedh përfaqësuesit e vet, për të vendosur se si funksionon vendi.

Në demokraci kemi të drejta të barabarta. Ne kemi të drejtë të shkollohemi, të luajmë, të shprehim mendimet tona, të ndërtojmë objekte, të punojmë, etj.

Ne sot mësuam se në demokraci ka bashkëpunim dhe tolerancë ndaj njëri-tjetrit.

### SI VEPROJNË QYTETARËT AKTIV

Qytetarët e mirë janë ata, të cilët janë aktiv në qytetin e tyre. Qytetarë quhen të gjithë njerëzit që jetojnë në një vend të përbashkët.

Ne si qytetarë duhet t'i respektojmë rregullat, për shembull: t'i respektojmë rregullat e komunikacionit, kur është drita e gjelbër e ndezur e semaforit duhet ta kalojmë, kurse kur është e kuqe nuk duhet ta kalojmë rrugën.

Pastaj, ne duhet ta ruajmë ambientin në të cilin jetojmë. Kur e ruajmë ambientin në të cilin jetojmë ne bëhemi qytetarë aktiv dhe demokratik, si dhe kujdesemi për shëndetin tonë.



Autorët e artikullit



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „MODEL“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IV-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë